



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas – Municipality of Drenas
Zyra e Kryetarit



REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		05/07/2024	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-400/01-31752			

**Raporti i dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore
(KAB) 2025-2027**

Korrik, 2024

Hyrje

Buxheti i Komunës së Drenasit për vitin 2025 është **22,133,550€**. Komuna vazhdon të dominohet në buxhetin total të saj nga transferet qeveritare të cilat edhe në tri vitet e ardhshme (2025-2027) do të përbëjnë afërsisht **91.25%** të buxhetit total të komunës. Të Hyrat Vetanake mesatarisht planifikohet të marrin pjesë në buxhet me **8.75%**, prej tyre të hyrat tatimore me **45.59%** ndërsa ato jo tatimore marrin pjesë më **54.41%**. Vlen të ceket se kufijtë e të hyrave sipas burimeve të financimit të buxhetit komunal janë caktuar me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2025-2027, lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, prill, 2024.

Duke u bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit, Statutit të Komunës së Drenasit, si dhe duke u bazuar në nenin 20 pika 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, Qarkores 01/23 dhe Qarkores 02/23 të Ministrisë së Financave, Grupi Punës në koordinim me kryetarin e Komunës së Drenasit z.Ramiz Lladrovci si dhe Zyrën për Komunikim me Publikun, kanë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për organizimin e dëgjimeve buxhetore publike me qytetarë për përgatitjen e buxhetit për vitin 2025.

Përgatitja e raportit është bërë duke u bazuar në nenin 20 pika 1,2,3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna. Në këtë raport mund të gjeni të dhëna që nga mbajtja e dëgjimit publik dhe mënyra e marrjes së kërkesës nga ana e qytetarëve (formë fizike, elektronike dhe në takimin direkt të mbajtur në lokalitet).

Me qëllim të informimit të qytetarëve për mundësit buxhetore dhe planifikimet paraprake të ndarjeve buxhetore në projekt buxhetin e komunës për vitin 2024, Grupi Punës në koordinim me drejtoreshën për buxhet dhe financa ka përgatitur një dokument të veçantë me informata të përgjithshme për projekt buxhetin e vitit 2025 duke përfshirë edhe ndarjet fillestare buxhetore të planifikuara. Ky dokument është shpërndarë në kopje fizike për të pranishmit-pjesëmarrës në dëgjimet buxhetore.

Ecure e procesit të dëgjimeve buxhetore për projekt buxhetin e vitit 2025

– Kryesuese, Albulena Saliuku, Arben Shala- ZK (Anëtar), Milaim Hajdari KK - Drenas (Anëtar), Avdyll Mziu - ZK (Anëtar), Kushtrim Bajraktari - ZKF (Anëtar), Lumnije Krapit - DSHMS (Anëtare), Anita Avdullahu- DBPZH (Anëtare), Petrit Gashi- DPUMM (Anëtar), Agnesë Kastrati Bucolli- DZHE (Anëtare), Laureta Thaqi- DAP (Anëtare), Enkela Dema- DKRS (Anëtare), Muhamet Gjoka - DKA (Anëtar), Endrit Gllareva- DIL (Anëtar), Enver Hoxha- DBF (Anëtar), Bekim Dobra- ZK (Anëtar), Lumturije Kiqina- DSHMS (Anëtar), Vlora Gjinovci- DIL (Anëtar), Nexhmedin Gruda – DSHPE (Anëtar).

Procesi i hartimit të projekt buxhetit të viti 2025 i ka paraprir miratimi i Koniozës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2024-2026. Grupi Punës në bashkëpunim me ekzekutivin e komunës si dhe Komitetin për Politikë dhe Financa (KPF) kanë organizuar 2 dëgjime buxhetore. Para miratimit të këtij dokumenti strategjik nga ana e Kuvendit të Komunës, ka organizuar një dëgjim buxhetor me qytetarë. Procesverbali nga organizimi i dëgjimit buxhetor, në pajtim me kërkesave ligjore është publikuar në web faqen e komunës.

Në suaza të ecurisë dhe planifikimit sa më të mirë të dëgjimeve buxhetore, Grupi Punues ka hartuar Planin e Brendshëm të Veprimit të organizmit të dëgjimeve buxhetore 2024, ku janë specifikuar obligimet ndërinstitucional me qëllim të organizmit sa më të mirë të dëgjimeve buxhetore. Në këtë kontekst, është përpiluar edhe kalendar për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore, ku si i tillë është përcjellë edhe me ftesat publike dhe informimi në kohë për ndryshimet që kanë ndodhur gjatë procesit të organizimit të dëgjimeve buxhetore. Ftesat dhe informatat për organizimin e dëgjimeve buxhetore janë publikuar në ueb faqen e komunës si dhe në mekanizma tjerë alternativ të tilla si: platformën e konsultimeve publike të nivelit qendror si dhe rrjetin social facebook :

<https://www.facebook.com/komunadrenas/posts/pfbid0D31qbLn46KR6bb8BVpRJpEJQNtDG65B2meJkGpXuxTnm9Bq9RAMd5VwcLAZtvrRxI>

<https://kk.rks-gov.net/gllogoc/category/degjime-buxhetore/>

[Konsultat publike | Konsultimet publike \(rks-gov.net\)](#)

Krahas planifikimit të dëgjimeve buxhetore me prezencë fizike, komuna e Drenasit ka synuar që projekt buxheti i vitit 2025 të jetë në konsultim edhe përmes formave elektronike, duke dhënë mundësi qytetarëve të kenë qasje në këto dokumente. Për më tepër, Qarkorja Buxhetore 01 dhe Qarkorja Buxhetore 02, janë publikuar në ueb faqen e komunës si dhe në platformën e konsultimeve në nivel qendror.

<https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/09/Buxheti-i-Komunes-per-vitin-2024-dhe-Parashikimi-i-buxhetiti-2025-2026.pdf>

Grupi punues, në kuadër të ndarjes së përgjegjësi dhe ndërmarrjes së aktiviteteve për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e konsultimit publik për projekt buxhetin e komunës, kishte planifikuar shfytëzimin e databazës së konsultimeve publike për të targetuar grupe të ndryshme qytetare dhe përfshirjen së tyre në proces të konsultimeve publike. Në këtë kontekst, grupi punues përmes Zyrës për Informim, përmes komunikimeve elektronike ka dërguar mbi 1000 ftesa të personalizuar për grupe të ndryshme qytetare përfshirë: OJQ, biznese, fermerët, ekzpert të fushave të ndryshme, drejtor të shkollave, përfaqësues të organizatave rinore, organizatave studentore, anëtarëve të KKS-së, anëtarëve të kuvendit të komunës etj.

Metodat e konsultimit	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime	Ndarja gjinore
Dëgjimi i pare publik me grupe të nënpërfaqësuar (administrator të vendbanimeve, këshillat lokale, gra, të rinj, studentë, pensionistë, persona me aftësi të kufizuar, punëtorë shëndetësor etj).	13.06.2024 10:30 - 11:30 1 orë	59 pjesëmarrës	13	34 M 25 F

Dëgjimi i dytë publik me grupe të interesit (biznese, fermerë, OJQ-të, shoqëri civile, klube sportive, klube artistike, etj).	13.06.2024 14:00 - 14:30 30 minuta	47 pjesëmarrës	0	22 M 25 F
---	--	----------------	---	------------------

Të gjitha kërkesat e parashtruara në takimet fizike si dhe ato në formë elektronike, janë shqyrtuar nga Grupi Punues, ndërsa raporti i detajuar për kërkesat e pranuar apo refuzuara, është paraqitur në formë të plotë në shtojcën nr. 1 të këtij raporti.

Projekt buxheti i vitit 2025, pas përmbylljes së procesit të dëgjimeve buxhetore, do të finalizohet dhe deri më 22 shtator 2024 do të procedohet për në kuvendin e Komunës së Drenasit.

Shtojca – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuar dhe të refuzuara.

Temat e dëgjimit buxhetor	Kërkesat/ Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për projekt buxhetin e vitit 2023	Statusi i kërkesës/ sugjerimi (i pranuar, pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar)	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
Projekt buxheti vitit 2024	Përgëzoj kryetarin Lladrovci për punën e deritashme edhe përkundër buxhetit të kufizuar dhe kërkesave të mëdha. Poashtu për vitet vijuese kërkoj ndriçim me arsyetimin se rrjeti i energjisë elektrike ka përfunduar dhe kanalizim në ato lagje ku ende nuk ka përfunduar rrjeti i kanalizimit.	Izet Bytyqi, përfaqësues nga fshati Fushticë e Epërme	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e ekzistencës së punës erdhi në përfundim se kërkesa për ndriçim do të realizohet sepse është kërkesë e arsyeshme dhe një kërkesë e tillë do të realizohet pasi që edhe ashtu është në proces implementimi i projektit të ndriçimit publik. Njëkohësisht edhe rrjeti i kanalizimit aty ku ka mbetur do të realizohet sepse grupi punues pajtohet rreth mundësive buxhetore për implementimin e projekteve të mbetura të kanalizimit.
Projekt buxheti vitit 2024	Kërkoj që të pastrohen mbeturinat, të përfundohen kanalizimet, rrugët dhe trotuarët.	Xhafer Doberdolani, administratori i fshatit Korroticë e Epërme	Pranohet	Grupi punues gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë ka arritur në përfundim që një kërkesë e tillë veçse është duke u implementuar por që u dakorduan që një fushatë më e madhe e pastrimit të mbeturinave të bëhet sidomos në zonën në mes fshatit Korroticë e Epërme dhe fshatit Vasilevë ku gjindet edhe liqeni i Vasilevës. Njëkohësisht u diskutua edhe raporti që dëshmonte se kishte pasur ndërhyrje nga

				Drejtoria e Shërbimeve Publike në fshatin Korroticë e Epërme ku ishte bllokuar kanalizimi dhe që një ndëryhrje e tillë kishte rezultuar me hapjen e sistemit të kanalizimit në këtë vend.
Projekt buxheti vitit 2024	Përsëendetje për të gjithë, në fshatin Sankoc, është punuar dhe po punohet, dhe për këtë ju përgëzoj si komunë. Kanë përfunduar shumë rrugë nëpër fshat dha shtrirje të rrjetit të kanalizimit poashtu. Për vitet 2025-2027 kërkoj trotuare, ndriçimi të bëhet aty ku ka shtylla të betonit dhe ku është frekuentimi më i madh i qytetarëve.	Kadri Ajazi, administrator i fshatit Sankoc	Pranohet	Grupi punues në konsultim me gjithë anëtarët e drejtorive përkatëse erdhi në përfundim se në fshatin Sankoc do të përfundohet me pjesët e mbetura nga projekti i ndriçimit publik, pra do realizohet edhe në ato pjesë të cilat kishte mbetur pa u realizuar. Njëkohësisht brenda mundësive buxhetore aty ku ka pronë publike do të realizohet edhe projekti i trotuareve që të lehtësojë lëvizjen e lirë të këmbësorëve.
Projekt buxheti vitit 2024	Kërkoj sqarim rreth Qendrës Rinore në Drenas. A do të ndërtohet Qendra e re apo jo??	Doruntina Gashi, OJQ Humanus Vita	Nuk pranohet	Pas kërkesës në fjalë Grupi Punues njëzëri është pajtuar Qendër e re rinore mund të ndërtohet vetëm nga investitorët për shkak të kufizimeve buxhetore por edhe për shkak të arsyes kryesore që është se veç se ekziston një qendër e tillë në Komunën e Drenasit. Realizimi i hapësirave tjera për të rinj është mëse i nevojshëm pavarësisht hapësirave ekzistuese por që limitet buxhetore determinojnë këtë proces. Sidoqoftë janë të mirëseardhura investimet e reja nga investitor të jashtëm.
Projekt buxheti vitit 2024	Dua të di diqka me shumë rreth projektit” “Ndertimi shtëpisë së komuniteteve”.	Lendita Elshani, Përfaqësuese e OJQ Handikos	Pranohet	Grupi Punues lidhur me kërkesën në fjalë erdhi në përfundim se projekti është në realizim e sipër, projekti do vazhdojë implementimin edhe në vitet vijuese deri në realizimin e tërësishëm të tij.

Projekt buxheti vitit 2024	Komorani II dhe III kanë kërkesë për rrethim të varrezave, trotuare si dhe depërtimin e ujërave të zeza tek rruga “Ymer Alushani”. Mirëpo fillimisht është mirë të informohemi rreth për investimet e vitit 2024 në mënyrë që të dijmë çka të kërkojmë për vitet 2025-2027.	Nasuf Mulaku, Administrator i fshatërave Komoran I&II:	Pranohet	Grupi Punues shtjelloi çështjet e ngritura nga administratori i Komoranit II dhe III e që konstatoi që janë në proces kërkesat e bëra nga administratori në fjalë. Njëkohësisht Grupi Punues informuan që investimet që janë bërë dhe po bëhen gjatë vitit 2024 të njoftohen në Tubimin me Publikun të raportimit të kryetarit të Komunës për aktivitetet e kryera gjatë gjashtëmujorit të parë si dhe në tubimin e fundvitit. Tubimi me publikun u potencua për shkak të afatit të afërt të mbajtjes së tij dhe angazhimit të qytetarëve për pjesëmarrje në këtë tubim.
Projekt buxheti vitit 2024	Në fshatin Tërstenik është punuar shumë dhe për këtë ju përgëzoj. Tersteniku I ka nevojë për një rrugicë 550 metra që të lidh lagjet Kacurreti dhe Dvorani. Poashtu të bëhet rruga e cila lidhë lagjen Kacurreti me parkun e Kamenicës.	Agim Kacurreti, përfaqësues i fshatit Tërstenik I	Pranohet	Çdo rrugë publike Grupi Punues ra dakord që të jetë prioritet të asfaltohet sepse duke paraparë punët që janë kryer dhe planifikimet buxhetore, ka mundësi që shumica prej tyre do të mund të kryhen. Kësisoj rrugicat apo rrugët dytësore do të mund të kryhen gjatë vitit të ardhshëm por edhe në këtë vit gjatë rishikimit të buxhetit nëse të njëjtat janë pronë publike. Pra kërkesat pranohen nga Grupi Punues.
Projekt buxheti vitit 2024	Përshëndetje të gjithëve, sa u perket fshatrave të cilat unë përfaqësoj, dua të theksoj që në to është punuar mjaft shumë mirëpo ka nevojë edhe për disa punë tjera. Kërkoj vigun pasi që prona është shpronësuar dhe është në nevojë të banorëve të fshatit tonë. Po ashtu kërkoj ndriçim nëpër lagje ku janë pa ndriçim, ujësjellës si dhe një pjesë asfalt. Për Poklek të Ri kërkoj edhe një fushë sportive.	Zekë Kluna, përfaqësues i fshatit Poklek i Vjetër, Poklek i Ri dhe Vasilevë	Pjesërisht pranohet	Grupi Punues ka shqyrtuar kërkesën e administratorit Kluna kësisoj kanë miratuar kërkesën e tij për të ndërtuar vigun, kërkesë kjo e bërë në vazhdimësi nga banorët në fjalë por që nuk kishte pas mundësi për shkak se i njëjti kalonte nëpër prona private. Meqenëse u njoftuam që prona nëpër të cilin kalon vigu është shpronësuar atëherë mund të vazhdojmë me procedurën e implementimit të projektit. Fusha

				Sportive do të shikohet se sa janë limitet buxhetore dhe se të njëjtat a do të mund të shfrytëzojnë palestrën dhe fushat sportive të shkollave të mesme sepse qeverisja lokale ka miratuar një vendim ku lejon shfrytëzimin e palestrave sportive nga rinia e vendeve përkatëse. Ujësjiellësi veç është funksionalizuar por që ka pasur disa dëmtime nga kompanitë publike në rrjetin e tij dhe që janë dakorduar të i sanojnë në një kohë sa më të shkurtër të mundshme.
Projekt buxheti i vitit 2024	Ju përshëndes të gjithëve, dhe falënderoj komunën për punën dhe angazhimin që keni bërë dhe po vazhdoni të bëni. Kam edhe dy kërkesa: ujësjiellës për Tërstenikun II si dhe trotuar për Tërstenikun I dhe II.	Bajram Qallapeku, administratori i fshatit Tërstenik	Pjesërisht pranohet	Grupi Punues pasi diskutuan rreth kërkesave në fjalë, ra në dakordim që do të pranohet kërkesa nëse ka hapësirë brenda kontratës ekzistuese ku parashihet të ketë punime në fshatrat Shtuticë dhe Vërboc, në të kundërtën do të pritët të bëhet kontrata e re. Trotualet sipas Grupit Punues do të vazhdojnë me implementim pasi të përfundojnë procesi i ndriçimit publik në tërë territorin e Komunës së Drenasit pasi që të dy projektet kanë kodin e njëjtë buxhetor dhe nuk mbulon kërkesat dhe nevojat e qytetarëve njëkohësisht.
Projekt buxheti i vitit 2024	Ju përshëndes të gjithëve, kam një kërkesë për rrugën kryesore Arllat-Negroc.	Xhevdet Krasniqi, administratori i fshatrave Negroc dhe Vuqak	Nuk pranohet	Grupi punues ka diskutuar rreth kërkesës në fjalë dhe ka njoftuar se për rrugën e njëjtë është bërë kërkesë në Ministrinë e Infrastrukturës për shkak se projekti i kësaj rruge ka kosto tejet të lartë.
Projekt buxheti i vitit 2024	Kam dy kërkesa për juve, ndriçimi të bëhet në dy lagje si dhe trotuari deri në Shtuticë.	Islam Sylaj, Administratori i fshatërave Shtuticë, Vërboc	Pranohet	Grupi Punues pas shtjellimit të kërkesave në fjalë erdhi në përfundim se kërkesa për ndriçim veç se është duke u realizuar dhe është në proces e sipër por që një gjë

				e tillë do kohë të realizohet në çdo cep të territorit të Komunës së Drenasit sepse janë kapacitete të limituara të kompanisë punëkryerëse. Me nënshkrimin e kontratës së re kjo kërkesë do të realizohet.
Projekt buxheti vitit 2024	Në listë të projekteve kapitale i keni ndarë për ujësjellës 400,000.00€, a c keni llogarit sa banorë do të përfitojnë nga ky projekt, ndriçim publik- ku do të bëhet, ndërtesa te banimit- të specifikohet çka do të bëhet, asfaltimet- a janë rrugë të reja.	Egzona Tërdeci, Asambleiste		Grupi punues pas komentit të asamblistës, ka njoftuar : • Projekti i ujësjellësit është një projekt 3 vjeçar dhe shuma buxhetore është e dedikuar për kontratën aktive. • Ndriçimi publik është duke u investuar në vazhdimësi, do vazhdohet në ato fshatra që kanë me pak ndriçim të përfunduar. • Asfaltimet janë projekt të cilat janë kontrata dy vjeçare si dhe segmente të reja në bazë të mjeteve buxhetore.
Projekt buxheti vitit 2024	Këndi i lojërave i cili qenka i përfshirë në listën e projekteve kapitale, kur të ndërtohet të kihet parasysh edhe fëmijë me aftësi të kufizuara.	Lendita Elshani, Përfaqësuese e HANDIKOS-it	Pranohet	Grupi punues pas analizës së kërkesës në fjalë ra në dakordim që një kërkesë e tillë do të realizohet sepse është jetike për nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuar. Kësisoj u pranua kërkesa në fjalë.
Projekt buxheti vitit 2024	Propozoj që Gryka e Kishnarekës të bëhet Park Nacional sepse është vend shumë i përshtatshëm. Kërkesat tjera i kam dorëzuar përmes protokollit.	Ymri Bajraktari, administrator i fshatit Kishnarekë	Nuk pranohet	Grupi punues pas analizës së kërkesës së bërë erdhi në përfundim se kërkesat e tilla për parqe nacionale janë kërkesa që duhen bërë në ministrinë përkatëse sepse është jashtë mundësive ligjore që këto procedura të zhvillohen në komunë

Komuna e Drenasit,
02.07.2024



Përpiluar nga:
Rexhe Mziu – Këshilltar politik